- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

##### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

##### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### **FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.



---

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Sasia e pritshme (racione ditore)</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.	Ushqim i gatuar e shpërndarë (katering)	43,800			
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					

---

<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

#### **FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

---

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

---

**Shtojca 5.**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt .....është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### SPECIFIKIMET TEKNIKE “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE E USHQIMI”

Operatori Ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

Produktet ushqimore, lënda e parë, që do të përpunohen, trajtohen apo ambalazhohen në ambientet e kuzhinës që disponon sipërmarrësi të jenë të shoqëruara me fletë analizën përkatëse.

OE duhet që në çdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plotë të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nëpërmjet gjurmshëmrisë së tij sipas VKM-së Nr.760, datë 16.09.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshët përgjatë ushqimit ushqimor” dhe analizave të ujit që përdor.

Magazinimi i lëndës së parë duhet të bëhet në dy forma:

- Në temperaturë ambjenti
- Në frigorifer ose dhoma frigoriferike

Magazinimi në temperaturë ambjenti bëhet në dollape/rafte metalike të lyera me ngjyrë të qartë në ambiente të destinuara ekskluzivisht për depozitimin e ushqimeve. Këto mjete janë të lashme për të thjeshtuar operacionet e pastrimit të sipërfaqeve.

Këto mjete janë bërë në mënyrë të tillë që të mos lihen volume bosh ose vende që mund të përbëjnë sipërfaqe kolonizimi nga insektet ose mikrobet.

Magazinimi në frigorifer ose dhomë frigoriferike bëhet në temperatura të ndryshme në funksion të produktit që konservohet duke filluar nga temperatura maksimale +5°C deri në -22°C. Të gjithë frigoriferët duhet të kenë një display të jashtëm me treguesit e temperaturës.

Vazhdimësia e energjisë elektrike tek motorët e frigoriferëve duhet të jetë e garantuar me gjeneratorë në pronësi të kompanisë.

Kushtet higjienike të lëndës së parë në fazën e stokimit duhet të jenë nën kontrollin e përgjegjësit të magazinës.

Operatori ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjedisit, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.



---

Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje dhe në respektim të standarteve të kërkuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, konform manualit të vetëkontrollit të HACCP.

Transporti i ushqimit të përgatitur nga kuzhina e shërbimit të ushqimit social për grupet e veçanta deri te konsumatori, të realizohet me mjete, pajisje dhe enë të posaçme (termuse) të llojeve dhe të madhësive të ndryshme në funksion të sasisë që ofrohet, si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit të produktit)

Produktet ushqimore (lënda e parë) që do të përpunohen, trajtohen apo ambalazhohen në ambjentet e përpunimit (kuzhinës) që disponon sipërmarresi do të jenë të shoqëruara me fletë analizën përkatëse.

Operatori ekonomik, të respektojë rregullat e higjienës për larjen, pastrimin dhe përpunimin e zarzavateve, frutave, sipas kërkesave të ligjeve në fushën e higjienës dhe ushqimit.

Operatori për qëllime higjene dhe pastrimi të përdorë detergjente dhe solucione kimike të certifikuara nga institucionet e njohura me ligj dhe të padëmshme për shëndetin e njerëzve të përcaktuara sipas akteve përkatëse (Urdhëri Nr. 365 dt. 03.08.2012 i Ministrisë të Shëndetësisë “Për miratimin e listës dhe përdorimin e lëndëve që përdoren për dezinfektim, deratizim desinsektim në shëndet publik”)

Operatori ekonomik duhet të sigurojë një higjienë të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhinës, ambienteve të gatimit, atyre të ndarjes së ushqimit dhe mensave.

Operatori duhet të realizojë larjen dhe dezinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren. Pastrimi i inventarit të imët kryhet nga operatori ekonomik, i cili duhet të mbajë dhe rregjistrat e pastrimit.

Në rast të sëmundjeve infektive, të përdoren për shpërndarje të ushqimit vetëm pajisje të vecanta dhe një përdorimëshe.

Operatori ekonomik, do të paketojë dhe të evadojë çdo ditë mbeturinat që krijohen si rezultat i prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të ushqimit, në vendet e caktuara si vend grumbullimi mbeturinash.

Materiali në kontakt me ushqimin (termuset, enët etj me të cilat transportohet ushqimi) të jenë material i përshtatshëm dhe lehtësisht të pastrueshme, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë të Bujqësisë Nr. 22, date 25.11.2010 “Kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”, me mbyllje hermetike (për të siguruar mbrojtjen nga mjedisi i jashtëm). Enët që përdoren për transportin dhe /ose shpërndarjen e ushqimit duhet të jenë me material jo të dëmshëm për shëndetin.

Punonjësit e operatorit ekonomik në momentin e përgatitjes / shërbimit të ushqimit në ambjentet e autoritetit kontraktor, duhet të jenë pajisur me uniformën, veshjen përkatëse të

---

punës (përparëse, grykëse, këpucë pantallona), këta të fundit të jenë të pajisur me librezë shëndetësore.

Operatori ekonomik duhet që në cdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plotë të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nepërmjet gjurmueshmërisë së tij, sipas VKM Nr. 760, date 16.09.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor” dhe analizave të ujit që përdor.

Operatori ekonomik është i detyruar të ruajë në raftet të vecanta në mjedisin e kuzhinës, kampionet e ushqimit të gatuar e që shpërndahet për ngrënie për të gjitha vaktet. Afati i ruajtjes së mostrave (kampionëve) është 24 – orë. Kur ka denoncime për cilësinë e ushqimit, ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave.

Operatori ekonomik, do të mbulojë shpenzimet ekonomike të nevojshme për realizimin e analizave laboratorike të mostrave të ushqimit të gatuar, sa herë që kërkohet nga autoriteti kontraktor.

Nga Operatori ekonomik privat kërkohet të plotësohet:

Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimorë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.189, datë 15.03.2017 "Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe të kursanteve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit si dhe shtetasve të ndaluar ose të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre”, normave e kalorive përkatëse të miratuara në Udhezimin të përbashkët të Ministrisë së Brendshme me Nr.942 , date 03.10.2017 dhe të Ministrisë së Shëndetësisë Nr.4130 datë 05.10.2017 “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, studentëve dhe kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit si dhe të shtetasve të ndaluar ose të arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre “.

Sipërmarresi është i detyruar të sigurojë të gjitha orenditë e pajisjet që nevojiten, për transport, shpërndarje dhe servirje.

Kontraktuesi duhet të realizojë shërbimin e ushqimit sipas normave të miratuara në pasqyren Nr.4 të Normave të ushqimit sipas sasisë e kalorive përkatëse të miratuara.

Sipërmarresi është i detyruar të sigurojë të gjitha orenditë e pajisjet që nevojiten, për transport, shpërndarje dhe servirje, si dhe pajisje për ruajtje të zakonshme dhe në kushte frigoriferike në ambientet e DVP Tirana, ku serviret ushqimi.

Zarzavatet duhet të përdoren gjithmonë të freskëta dhe asnjëherë të konservuara si dhe duhet të plotësojnë kushtet përkatëse sipas STASH të shoqëruara me fletë analize përkatëse.

Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimorë sipas normave e kalorive përkatëse të miratuara në urdhrat dhe VKM.

---

Mishi duhet të jetë mish viçi i freskët, cilësia e parë dhe i shoqëruar me raport mjekësor veterinar, bazuar në STASH.

Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menusë javore të ushqimit të miratuar, konformë normës bazë të ushqimit e cila duhet të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura sipas normës bazë të ushqimi.

Shërbimi do të serviret në vartësi të numrit të të ndaluarve, sipas orarit të percaktuar për të tre vaktet e ngrenies së ushqimit në DVP Tirana sipas vendndodhjeve të tyre.

Shpërndarja e ushqimit deri tek të ndaluarit do të bëhet me pajisje të përshtatshme të ambalazhuara bazuar në specifikën që mbart ky shërbim për persona të ndaluar. Ushqimi të serviret i ngrohtë për çdo vakt sipas orarit të percaktuar.

- Mëngjesi ora 07:00 - 09:00,
- Dreka ora 12:00 - 13:30,
- Darka ora 18:00 - 20:00.

Në momentin e dorëzimit të ushqimit në prezencë të dorëzuesit dhe pranuesit të ushqimit ndahet një mostër ushqimi e cila ruhet në ambientet e sistemit të sigurisë në kushte frigoriferike, të siguruar nga ana e kontraktuesit (firmës fituese). Afati i ruajtjes së kampioneve është 24 orë dhe vulozet nga mjeku dhe oficeri i rojës.

Sipërmarrësi me anë të strukturave përkatëse do të rakordojë me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse çdo muaj për racionet ditore të porositura sipas normave përkatëse, të bazuara në raport forcat e ushqimit të lëshuara nga Shefi i Sallës së Komandimit në Drejtorinë Vendore e Policisë Tiranë për Aparatin e Drejtorisë dhe për Komisarariatet në vartësi të saj.

Ushqimi i gatuar sipas normave, të shoqërohet me dokument dalje ditore për Drejtorinë Vendore të Policisë.

Produktet ushqimore dhe ushqimi i gatuar nga operatori ekonomik do t'i nënshtrohet kontrolleve nga Autoriteti Kontraktor duke ju referuar specifikimeve teknike të tyre për cilësinë, sasinë dhe normën sipas menusë javore.

Furnizimi me ujë, energji, gaz:

Furnizimi me ujë, enegji, gaz do të kryhet në bazë të kontratave të lidhura nga kontraktuesi dhe ndërmarrjet përkatëse furnizuese. Për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit është e nevojshme Në rast ndërpreje të burimeve të furnizimit, të vërë në dispozicion burime alternative furnizimi me këto shërbime me mareveshje midis palëve.

Sipërmarrësi që do të kryejë këtë shërbim, duhet të lidhë kontratë për energjinë dhe ujin e pijshëm, me institucionet përkatëse (OSHEE dhe Ujësjellësin) duke zbatuar të gjitha rregullat dhe udhëzimet nga institucionet përkatëse.

Norma e Ushqimit për të ndaluarit dhe të arrestuarit për një racion ditor (R/D) është si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Buke R.75	kg	0.4
2	Oriz	kg	0.04
3	Makarona	kg	0.04
4	Fasule	kg	0.04
5	Mish viçi	kg	0.08
6	Vaj ushqimore	kg	0.03
7	Sheqer	kg	0.02
8	Djath i bardhe	kg	0.04
9	Qumësht i freskët	kg	0.25
10	Vezë	kokërr	1
11	Perime gatim +sallate	kg	0.3
12	Fruta (mollë+portokall)	kg	0.2
13	Salcë	kg	0.004
14	Çaj mali	kg	0.002
15	Kripë	kg	0.005

Personi i autorizuar për ndjekien e shërbimit do të jetë: Shefi i Seksionit të Shërbimeve në DVP Tiranë.

Operatori ekonomik merr përsipër kontrata të rregullta pune për personelin e shërbimit duke kryer pagesat e sigurimeve shoqërore.

Të gjithë punonjësit e operatorit ekonomik duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me shenja dalluese përkatëse të shoqërisë.

Operatori ekonomik duhet t'i kompletojë të gjitha mjetet dhe pajisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë.

Operatori ekonomik do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktor konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme ose është mjaft i pakënaqur nga puna e këtij personi.

Personeli do të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shëndetësor.

### **Përshkrimi i shërbimeve:**

Furnizimi i lëndës së parë, përgatitja, gatimi dhe shpërndarja e ushqimit për 3 vakte sipas programit ushqimor të përgatitur dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor (Nga Shefi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse).

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimin e ushqimit sipas normave.

Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimore sipas sasisë e kalorive përkatëse të miratuara.

---

Nuk lejohet në asnjë rast dhe për asnjë arsye zëvendësimi nga operatori ekonomik i artikujve ushqimorë që janë të përcaktuara në normën bazë të ushqimit dhe menunë javore pa miratuar nga Autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menusë konform normave bazë të ushqimit.

Menuja e ushqimit do të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura sipas normave bazë të ushqimit.

### **Programi Ushqimor**

Llojshmëria e ushqimit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara nga programi dhe menuja e përgatitur nga shërbimi i ushqimit dhe i shëndetësisë të DVP Tiranë në bazë të normave.

Ky program ushqimor do të ketë dhe konfirmimin e sipërmarrësit. Sipërmarrësi do të zbatojë planin e menusë ditore të ushqimit sipas programit të miratuar nga DVP Tiranë.

Shërbimi do të realizohet sipas nevojave (kërkesës) të DVP Tiranë për numrin e të ndaluarve dhe të arrestuarve sipas raport forcës të lëshuar nga salla e drejtimit e komandimit për të 3 vaktet ditore (mëngjes, drekë, darkë).

## **Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

#### **Shërbimi që kërkohet:**

Shërbim gatimi për nevojat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

Shërbimi do të serviret në vartësi të numrit të të ndaluarve dhe të arrestuarve, sipas orarit të përcaktuar për të tre vaktet e ngrënies së ushqimit sipas vendndodhjeve të tyre.

#### **Afatet e ekzekutimit:**

<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma totale e racioneve ditore</b>	<b>Vendi i ekzekutimit</b>	<b>Afati i ekzekutimit</b>
Shërbim gatimi për nevojat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë	Sipas specifikimeve dhe termave të referencës	43,800	Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë	Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda vlefshmërisë së Marrëveshjes Kuadër

Afati i ekzekutimit të shërbimit është: Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda vlefshmërisë së Marrëveshjes Kuadër.

Shërbimi do të realizohet sipas nevojave (kërkesës) të DVP Tiranë për numrin e të ndaluarve dhe të arrestuarve, sipas raport forcës të lëshuar nga salla e Drejtimit e Komandimit në DVP Tiranë, sipas vakteve.

---

## **Shtojca 8.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

#### **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**

Shërbim gatimi për nevojat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me qëllim që të sigurohet gatimi dhe shpërndarjen e ushqimit për të ndaluarit dhe të arrestuarit.

#### **Objektivat:**

Të sigurojë furnizimin në kohë dhe me cilësinë e kërkuar të ushqimit të gatuar.

Të garantojë në çdo kohë shumëllojshmërinë dhe kalorinë e nevojshme sipas normës për të ndaluarit dhe të arrestuarit.

Të sigurojë ushqim të sigurtë për mbrojtjen e shëndetit nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga ushqimi.

Të bëjë kompletimin e ambienteve (mense e kuzhinë) me pajisjet e domosdoshme për furnizimin, përgatitjen, gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit.

Të sigurojë gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit, sipas vakteve dhe normave.

Të sigurojë kushtet e nevojshme higjieno sanitare për realizimin e shërbimit.

Të sigurojë shërbim me standarde të larta.

**Detyrat:** Furnizimi në kohë, me korrektësi dhe konform specifikimeve të kërkuara.

**Shpërndarja:** Sipas përcaktimeve në keto DST

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Në DVP Tiranë dhe Komisaritet e Policisë në Vartësi

---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.



---

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

2.1.1 Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

2.1.2 Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën 1 (një) stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi.

2.1.3 Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se stabilimenti plotëson kushtet higjierno-sanitare dhe tekniko-teknologjike për veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes me shumicë të ushqimeve për njerëz.

2.1.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 8 (tetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1.	Drejtues teknik/Përgjegjës Shërbimi	1 (një)
2.	Kuzhinier	2 (dy)
3.	Ndihmës Kuzhinier	2 (dy)
4	Punonjës shpërndarës ushqimesh	2 (dy)
5.	Shofer	1 (një)
	<b>Total</b>	<b>8 (Tetë)</b>

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

**a) Për drejtuesin teknik/ Përgjegjës Shërbimi :**

- Diplomë me profesion Mercollog/Kimist/Teknolog Ushqimor,
- Kontratë pune (e vlefshme), si drejtues teknik/përgjegjës shërbimi;
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

**b) Për Kuzhinierin:**

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune si kuzhinier, (e vlefshme)

- 
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

**c) Për ndihmës kuzhinierin**

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier (e vlefshme).

**c) Për Punonjes shperndares ushqimesh:**

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi (e vlefshme).

**d) Për punonjesit Shofer, të paraqitet:**

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se mundësojnë transportimin e ushqimit me mjetet e veta, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë se ushqimi do të etiketohet dhe do të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë e tij sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatorë ekonomikë duhet të deklarojnë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët.

---

2.3.8 Operatorë ekonomike duhet të deklarojnë se produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve janë në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, konform manualit të vetkontrollit HACCP.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 10.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
